

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndryshimi i Ligjit për Specialen, nisma i dërgohet Qeverisë për mendim
ADRESA	https://dosja.al/politike/ndryshimi-i-ligjit-per-specialen-nisma-i-dergohet-qeverise-per-mendim-i515982
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 12:09:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:57:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	92ed95e76cb68f66660011c40c7b84d97a128c474fe8030b7627a01f0738054c
TEKSTI	cb6dacc944a01e297263462c9544bf2921b7f4809168a2cf7f151006394b19db
PAMJA	416643cdc2d91ba05a1e9f9df7e4f68d6be07eb8d1a9c969850503c067c8c72d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d216e1b8fd735974ba5e60af455425eaa8cb2bd52116cd14fc86554a4bd637b8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d216e1b8fd735974ba5e60af455425eaa8cb2bd52116cd14fc86554a4bd637b8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

14 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salle në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranien. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtra të pabaza

19 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

22 ORE ME PARE

Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

22 ORE ME PARE

Skandali SHISH/ Vlora Hyseni vë në rrezik vendin për Ergys Agasin: Të gjithë radarët e shtetit i mbyll për ty

Politike

Ndryshimi i Ligjit për Specialen, nisma i dërgohet Qeverisë për mendim

Lidhur me aktgjykimin dënues të 16 shtatorit ndaj katër ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Kryesia është pajtuar që të hënën e 28 shtatorit të dalë me një deklaratë të përbashkët.



25 Shtator 2026, 13:57
Nga E. D



Arian Tahiri, deputet i PDK-së

KOSOVË- Nisma për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është dërguar për mendim në Qeverinë e Kosovës, u bë e ditur pas mbledhjes së parë të Kryesisë së Kuvendit të legjislaturës së 11-të.

Lidhur me aktgjykimin dënues të 16 shtatorit ndaj katër ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Kryesia është pajtuar që të hënën e 28 shtatorit të dalë me një deklaratë të përbashkët. Më 21 shtator, Partia Demokratike e Kosovës - forca e dytë politike e dalë nga zgjedhjet e qershorit - dorëzoi në Kuvend projektligjin.

Në dokumentin e ndryshimeve të propozuara, të cilën e ka parë Radio Evropa e Lirë, kërkohet ndër të tjera, që dënimet më të larta që mund të shqiptohen nga Gjykata në Hagë të jenë 15 vjet burgim dhe që të dënuarit të mund të jenë subjekt i faljes presidenciale. Sipas Arian Tahirit nga PDK-ja, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, është zotuar që të angazhohet që nisma të trajtohet me shpejtësi nga ekzekutivi.

"[Kryetarja e Kuvendit, Albulena] Haxhiu u zotua se personalisht ajo do të angazhohet dhe do të komunikojë me Kurtin që të trajtohet me urgjencën e nevojshme", tha ai pas mbledhjes së parë të Kryesisë së Kuvendit.

Haxhiu, ndërkaq, sqaroi se Qeveria ka kohë 30 ditë për ta shqyrtuar nismën, por u zotua se do ta adresojë sërish çështjen, që ekzekutivi ta trajtojë me prioritet, duke shtuar se "tani i kemi ditët e numëruara" pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ju referua 6 tetorit - datës së fundit kur deputetët duhet të zgjedhin presidentin e ri vendit, pasi në të kundërtën, tha Haxhiu, vendi do të shkojë në zgjedhje.

"Kur flasim për vendimin në Hagë, nuk i ndihmojnë atyre në Hagë që ne me vetëdije të plotë, pa kokëçarje e çojmë vendin në zgjedhje. Mendoj që ka hapësirë të bëhemi bashkë dhe ta procedojmë një emër për president", tha ajo.

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se
ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fshta motrën"/ Shefi i
Policisë së Krujës shan
qytetarin, ai zbret nga makina
dhe e qëllon me shpullë
(VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe
krimi i organizuar u bënë
njësh në mbrojtje të Ergys
Agasit



Dy ditë më parë, Gjykata Kushtetuese doli me njoftim, duke thënë se Qeveria e re e Kosovës është zgjedhur në mënyrë kushtetuese, Kuvendi është konstituuar, ndonëse jashtë afatit kushtetues dhe se deputetët duhet të zgjedhin presidentin deri më 6 tetor. Haxhiu kritikoi Kushtetuesen, duke thënë se po krijon norma të reja kushtetuese, duke shtuar se tani doli me një afat tjetër për presidentin, krahasuar me aktgjykimin e vitit të kaluar.

"Jam e shqetësuar me mënyrën si i trajton gjykata lëndët. Ajo nuk është gjykatë që duhet t'ua bëjë qejfin partive politike", tha Haxhiu, e cila është ushtruese e detyrës së presidentit.

E pyetur se kush i shpall zgjedhjet pas 6 tetorit, Haxhiu tha se ka interpretime të ndryshme për këtë çështje, dhe shtoi se duhet pritur publikimi i aktgjykimit të plotë për të parë nëse Kushtetuesja e ka trajtuar edhe këtë aspekt.

Arbërie Nagavci nga Lëvizja Vetëvendosje, ndërkaq, tha se duke pasur parasysh situatën me të cilën po përballët Kosova pas vendimit të Hagës, vendi duhet të ketë institucione me mandat të plotë, përfshirë presidentin.

Nagavci u shpreh se kreu i partisë do të tregojë se shpejti nëse do të ketë takime me subjektet politike, por shtoi se partia e saj do të angazhohet maksimalisht për zgjedhjen e presidentit.

Nëse deputetët nuk arrijnë të gjejnë pajtim për presidentin, vendi rrezikon të shkojë drejt zgjedhjeve të reja. Ato do të ishin votimet e katërta që nga shkurti i vitit 2025 dhe të dytat për shkak të moszgjedhjes së presidentit.

Por, për Tahirin e PDK-së, prioritetet është çështja e aktgjykimit në Hagë dhe madje tha se në takim nuk është diskutuar për presidentin. Ai madje tha se vendimi i 16 shtatorit nuk duhet të lidhet me tema politike.

"Rrethanat që janë dhe jemi kërkohet përgjegjësi kombëtare, politike dhe karshi kësaj, ne jemi duke thirrur në unitet kombëtar dhe politik", tha Tahir.

Partia Aleanca tha se mbështet nismën e PDK-së për ndryshimin e ligjit dhe çdo nismë që ndihmon në lirin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, që u dënuan për krime lufte nga shkalla e parë e mekanizmit të drejtësisë në Hagë, që njihet si Gjykata Speciale.

Kryeparlamentarja Haxhiu tha se projektligjin e PDK-së e ka dërguar te një ekip ekspertësh, por ende nuk mund të japë një vlerësim për përmbajtjen e tij.

Megjithatë, ajo pati kritika që për të nuk ka pasur konsultime, duke shtuar se do të ishte më e drejtë që ai të hartohej nga Komisioni për legjislacion ose paraprakisht të konsultohen ekipet mbrojtëse të katërshes së UÇK-së dhe ekspertë të fushës.

"Unë mendoj se nuk bëjmë mirë nëse nuk i konsultojmë ekipet mbrojtëse për çfarëdo nisme ligjore", tha ajo.

Kritika të ngjashme pati edhe Arbërie Nagavci nga Lëvizja Vetëvendosje, e cila tha se partia e saj, por as partitë e tjera nuk janë konsultuar për këtë projektligj.

"Nga sot kemi 11 ditë që të zgjedhim presidentin. Në këtë pikë është e rëndësishme që çështjet e rëndësishme t'i adresojmë me një strategji shtetërore, pa protagonizma, por duhet të përmendet që askush nga LVV-ja nuk është konsultuar me këtë nismë të PDK-së. Kjo duhet të jetë një nismë që na bashkon", tha ajo.

Paraprakisht, LVV-ja ka thënë se do ta shqyrtojë projektligjin e propozuar në aspektin juridik, përfshirë edhe përputhshmërinë e tij me kornizën ligjore në fuqi dhe "efektet që një ndërhyrje e tillë eventualisht mund të ketë në këtë fazë të procedurave pranë Dhomave të Specializuara".

Vetëm nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fuqia e tretë politike në Kuvendin e Kosovës, nuk kanë dalë me një qëndrim zyrtar rreth projektligjit për Specialen. Nisma e PDK-së vjen në kohën kur po mbahen protesta të përnatshme në Prishtinë në kundërshtim të vendimit të Gjykatës Speciale./REL

kosove arian tahiri deputet i pdk-së

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 07:44

"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

më të klikuarat

- 

"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren
- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit
- A e fshehu telefonin Ilir Proda? Gazetari Ferhati: Në SPAK deklaroi se i ishte thyer
- "Të q"fshe motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbrit nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

insights

- Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat
- Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë
- Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen
- Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow

Sondazh

Poll

Politike

25 Shtator 2026, 13:33

Këshilli Bashkiak i Tiranës kërkon Erion Veliajn në mbledhje, kërkesë SPAK-ut: Nëse nuk është e mundur fizikisht të lejohet online

TIRANË- Këshilli Bashkiak i Tiranës i ka kërkuar SPAK-ut dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që të mu...

Të hënën mbledhet Këshilli i Sigurisë/
Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për
spektakël institucional, por për përgjigje.
Begaj të jap llogari njëlloj si Rama

Politike

25 Shtator 2026, 13:09

Sulmi i Vlorë Hysenit ndaj gazetares
Lala/ Luarasi: Reagimi i ish-drejtueses së
SHISH është i papranueshëm

Politike

25 Shtator 2026, 12:20

"TIMAK Defence" dhe KAYO në qendër të
denoncimit të PD: Thesari pagoi 8.6 mln
lekë, si u lëshua fatura para procedurës?

Politike

25 Shtator 2026, 10:31

"Europa nuk ka arritur ta zbatojë" / Rama
nga SHBA: Paqja kusht politik që
zhvillimi ekonomik e bën të mundur

Politike

25 Shtator 2026, 10:25

Politike

25 Shtator 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

Vlora Hyseni TIRANË- Mëngjesin e 22 shtatorit, forcat e Policisë së Shtetit zbarkuan për kontroll në një kompleks vilash...

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit

Politike

25 Shtator 2026, 08:42

Kurti në 3-vjetorin e sulmit në Banjskë: Radoiçiç duhet të përballet me drejtësinë në Kosovë për sulmin, drejtësia nuk do të ndalet

Politike

24 Shtator 2026, 22:30

Analiza: Çfarë strategjie mund ta ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?

Politike


24 Shtator 2026, 18:10

BE: Keqardhje që Serbia s'ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për sulmin në Banjskë

Politike

24 Shtator 2026, 17:39

MË SHUMË



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllonjë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Mbyllen fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit...



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Aktivisti Lika për Vlora Hysenin: Nuk duhej të futej në SPAK, duhet të jetë në burg

Aktivisti Arben Kola thirrje shqiptarëve në SHBA: Priteni Ramën me vezë para OKB-së...

Shiko video te tjera

KTHEHUNE KRYE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.